




REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA HANI I ELEZIT -

MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT



Nr.02/ 13.54 / 2024

Data: 15.02.2024

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.01/10771/2023, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, lidhë këtë:

## MARRËVESHJE

### PËR

## HEQJEN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

E lidhur ndërmjet Kryetarit të Komunës Mehmet Ballazhi në njërën anë si përfaqësues i Komunës së Hanit të Elezit dhe

Kryetarit të Bashkësisë Islame, dega në Han të Elezit Dr.sci. Musa Vila si përfaqësues i BI në anën tjetër.

### Qëllimi i marrëveshjes

- Komuna e Hanit të Elezit lidh këtë marrëveshje me Bashkësinë Islame dega në Han të Elezit me qëllim të heqjes së shpenzimeve të varrimit për të gjitha rastet mortore, për të gjithë qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit pa dallim, e cila do të fillojë të implementohet nga 01.02.2024 dhe do të përfundojë vetëm me marrëveshjen e palëve.
- Palët pajtohen që për çdo person të vdekur shpenzimet e varrimit të jenë në shumë prej 250 euro pavarësisht moshës së të vdekurit.
- Palët pajtohen se në këtë marrëveshje sipas nenit 2 do të përfshihen:

- Lajmërimi (temxhidi)
- Pastrimi i xhenazes
- Dërrasat e varrimit
- Mbëshhtëllësi (qefini)


- Falja e xhenazes dhe
- Çertifikata e vdekjes

4. Komuna merr obligim që mjetet e shpenzimit të varrimit t'i deponon në xhirollogarinë e Bashkësisë Islame në Han të Elezi: XK05 1703 0016 0000 0855 , sipas numrit të certifikatës së vdekjes , në çdo tre muaj.
5. Palët merren vesh se nuk do të ketë ndonjë kontest në të ardhmen për këtë çështje në asnjë mënyrë, mirëpo nëse eventualisht lind ndonjë kontest, kompetente për shqyrtim të çështjes do të jetë Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit si organi më i lartë i komunës.

### **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit dhe Kryetarit të Bashkësisë Islame në Han të Elezit.

### **PALET NËNSHKRUESE TË MARRËVESHJES**



Kryetari i Bashkësisë Islame  
Dr.sci. Musa Vila

